



Datë: 07.07.2025
Numër Protokolli: 4896/2025

A.nr.736/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.736/2025, të datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesja M.G-K, nga Peja, kundër organit të punësimit/Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*transferim pas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.736/2025, e datës 28.04.2025, e parashtruar nga ankuesja M.G-K.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.G-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 28.04.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2768/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.736/2025, kundër Vendimit me Nr.48/2024 të datës 23.12.2024, të Zv. Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 12.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa kjo e fundit, me datë 11.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3948/2025 të datës 11.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pasafatshme**, sepse: Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit të datës 10.01.2015,

është e punësuar në pozitën e punës *Asistente Administrative* në kuadër të Zyrës Regjionale në Pejë/Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Tutje, nga provat e lëndës rrjedhë se Agjencia e Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronës ka miratuar Rregulloren Nr.01/2024 për Standardet e Organizmit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, dhe si rezultat i miratimit të kësaj rregullore, më datë 25.04.2024, Zyrtari Kryesor Administrativ me Vendimin Ref.nr.00561/24, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit, ndërsa, ky i fundit më datë 02.12.2024, ka miratuar Raportin Ref.Nr.01809/24, ku lidhur me procesin e ristrukturimit të ankueses ka rekomanduar transferimin nga pozita *Asistente Administrative-Profesional 3*, në pozitën *Zyrtar regjional i pranimit-Profesional 3*.

Në zbatim të rekomandimit të Komisionit të Ristrukturimit, Zv. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në AKKVP me Vendimin Nr.48/2024, të datës 23.12.2024, ka transferuar ankuesen në pozitën e punës *Zyrtar regjional i pranimit-Profesional 3* në kuadër të Zyrës Regjionale në Pejë/Departamenti për Koordinim Regjional, dhe si për rrjedhojë më datë 06.01.2025, ankueses i është lëshuar edhe Akt emërimi me Nr.00089/2025, të cilin e njëjta e ka nënshkruar me datë 13.01.2025.

Ankuesja, kundër Vendimit me Nr.48/2024 të datës 23.12.2024, të pranuar me datë 30.12.2024, ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke theksuar ndër të tjera se lidhur me çështjen përkatëse paraprakisht ka parashtruar disa kërkesa tek organi i punësimit duke shprehur shqetësimet e saj lidhur me transferimin.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ., dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja, me datë 28.04.2025 është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.48/2024 të datës 23.12.2024, Zv. Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, lidhur me transferimin pas ristrukturimit, i cili vendim sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht sipas e-mailit zyrtar të z.B.C konstatohet se ankueses i është dërguar në po të njëjtën ditë apo më datë 23.12.2024, ndërsa sipas thënieve në ankesë e ankuesja deklaroi se e ka pranuar të njëjtin akt më datë 30.12.2024, nga rrjedh se ankesa e datës 28.04.2025 është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit **127 paragrafi 1** të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase akti kontestues përmban Këshillën Juridike, ku sipas këtij udhëzimi e njëjta është dashur që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi të parashtrojë ankesë pranë Këshillit.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.736/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.G-K;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.